



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE



ФОНДАЦИЈА ЗА ОБРАЗОВНИ И КУЛТУРНИ ИНИЦИЈАТИВИ
FOUNDATION FOR EDUCATION AND CULTURAL INITIATIVES
ЧЕКОР ПО ЧЕКОР • STEP BY STEP

Numri 3

10-dhjetor, 2013 – 31 janar, 2014

E-lajme

Projekti i USAID-it “Leximi ju bën udhëheqës”

Dije nga fusha e gjuhës dhe matematikës për zhvillim intelektual

Projekti është implementuar nga ana e Fondacionit për iniciativa arsimore dhe kulturore “Hap pas hapi” – Maqedoni

Të nderuar lexues,

Ky është edicionin e parë e lajmeve tona elektronike në vitin e ri dhe në gjashtëmujorin e ri. Na pret një periudhë plot aktivitete për gjithë ju që jeni pjesë ose doni të kyçeni në projektin. Në këtë numër të e-lajmeve do të lexoni se çka punoi ekipi i projektit në fund të vitit të kaluar, si dhe çka planifikojmë të punojmë në periudhën që vjen.

Kënaquni duke lexuar!

Ju përshëndes ekipi i projektit



Instrumentet EGRA dhe EGMA janë pilotuar në shkollat e përzgjedhura

Në periudhën prej 4 deri në 24 dhjetorin, instrumentet për vlerësim të dijes nga gjuha dhe matematika EGRA dhe EGMA në mënyrë të suksesshme u pilotuan në 21 shkollat e përzgjedhura për fazën e parë. Gjithsej 2000 vlerësime të njohurive nga gjuha amtare dhe matematika u zbatuan nga ana e pedagogëve/psikologëve të trajnuar, të cilët ishin në rol testatorësh. Këshilltarët nga Byroja për Zhvillim të Arsimit dhe Qendra Shtetërore për Testim, anëtarët e grupeve punuese për EGRA dhe EGMA, si dhe koordinatore të rajonale të Fondacionit “Hap pas hapi” zbatuan 35 mbikëqyrje në shkollat, me qëllim që të identifikohen mungesat e mundshme në kushtet teknike, udhëzimet e detyrave ose te vetë detyrat. Rezultatet e nxënësve përpunohen në bashkëpunim me Qendrën Shtetërore për Testim dhe së bashku me rekomandimet e mbikëqyrësve do të diskutohen me të gjitha palët e përfshira në këtë proces. Në atë mënyrë do t'i përmirësojmë detyrat edhe më shumë dhe do të përgatitemi për studimin për gjendjen fillestare i cili është planifikuar për në fund të këtij viti shkollor.

Karvani

ishkronjave dhe numrave

Aktivitete në shkollat

Siç ju lajmëruam në edicionin e mëparshëm të lajmeve tona elektronike, Karvani i shkronjave dhe numrave vazhdoi me vizitat nëpër shkollat e fazës pilot të projektit edhe në dhjetor. Nxënësit e klasave të ulëta, familjet e tyre dhe përfaqësues të tjerë të komuniteteve lokale u kënaqën në ngjarjet e organizuara së bashku me personat e famshëm. Aktorët Zoran Ljutkov, Zorica Pançiq, Zarije Jonuzi dhe Fisnik Zeqiri ishin vetëm disa prej personave të famshëm të cilët u shoqëruan timit tonë për të ofruar edhe më shumë zbavitje dhe gëzim në procesin e mësimin të nxënësve në shkollat të cilat i vizituam.



Më shumë se 200 nxënës në Karvanin në SHF "Bllazhe Koneski" - Veles



Nxënës dhe përfaqësues nga komuniteti lokal në Karvanin në SHF "Liria" - Jabollçishte e Epërme, Çashkë

Projekti "Leximi ju bën udhëheqës" në tryezë të rrumbullakët për resurset e hapura arsimore

Në dhjetor, përfaqësues të Projektit "Leximi ju bën udhëheqës" ishin pjesë e tryezës së rrumbullakët në temën "Resurset e hapura arsimore: Përvojat, përfitimet, sfidat, çështjet e hapur dhe hapat e ardhshëm". Kjo ngjarje ishte organizuar nga ana e Fondacioni "Metamorfozis" dhe në atë morën pjesë 35 përfaqësues prej shkollave fillore dhe të mesme, prej universiteteve, bibliotekave, organizatave joqeveritare dhe institucioneve publike. Përveç diskutimit, organizatorët e prezantuan edhe Aleancën për resurse të hapura arsimore. Kjo Aleancë është iniciativë e cila ka për qëllim të krijojë bibliotekë digjitale e cila do t'i përmbajë të gjitha resurse arsimore me kod të hapur ose resurse me licencën "Creative Commons". Projekti i USAID-it "Leximi ju bën udhëheqës" e përkrah këtë iniciativë dhe do të sigurojmë qasje për të gjitha resurset tona arsimore, me qëllim që ata të dëshpërojnë në publikun e gjerë. Më shumë detaje për RHA mund të lexoni në këtë link: <http://oer.mk/>



Tryeza e rrumbullakët për resurset e hapura arsimore

Materiale të reja arsimore

Në periudhën e kaluar, komponenta e projektit për Resurse digjitale për mësim bashkëpunoi me grupin punues edukatorësh me qëllim që të selektojnë dhe të lokalizojnë libra të përshtatshme dhe interesante për nxënësit e klasave të ulëta. Librat me vizatime përgatiten edhe në formë audio dhe shpeshojmë se do të jenë në dispozicion në faqen tonë të internetit që në javën e parë të shkurtit. Ndërkohë, grupi punues do të përzgjedhë edhe 16 libra të tjera të cilat do të përgatiten gjatë këtij viti.

Skopje City Mall është miku më i ri i Projektit të USAID-it "Leximi ju bën udhëheqës"

Projektii USAID-it "Leximi ju bën udhëheqës" ka filluar bashkëpunim me Skopje City Mall me qëllim që të ofrojë mundësi shtese për nxënësit më të rinj dhe familjet e tyre të kyçen në aktivitete zbavitëse të lidhura me leximin dhe matematikën edhe gjatë fundjavës. Klubi për fëmijë, kënd i specializuar përfëmijë i cili pëndodhet në katin e dytë të qendrës tregtare do të jetë vendi ku ekipi e projektit do t'ju mirëpresë një herë në muaj (një e shtune). Ju mirëpresim në ngjarjen tonë të parë "Leximi dhe matematika janë zbavitëse" më 15 shkurt, në orën 12:30 dhe të bëhuni pjesë e programit zbavitës me aktorin Gorast Cvetkovski!

Në shkurt na pritet:

Jeni të mirëpritur në ngjarjet e planifikuara "Leximi dhe matematika janë zbavitëse" ku mund të zbavitëni me disa prej aktorëve dhe këngëtarëve tona më të preferuar:

5 shkurt, 10:00

SHF "Vasil Glavinov" - Veles, së bashku me Kristina Arnaudova dhe Amernis Nokshiqi

5 shkurt, 12:00

SHF "Jordan Haxhikonstantinov Xhinot" - Veles, së bashku me Kristina Arnaudova dhe Amernis Nokshiqi

6 shkurt, 10:00

SHF "Përparimi" - Çegran, Gostivar, së bashku me Zarije Jonuzi dhe Igor Angelov

6 shkurt, 12:30

SHF "Andreja Savevski Kikish" - Tetovë, së bashku me Zarije Jonuzi dhe Igor Angelov

11 shkurt, 12:00

SHF "Drita" - Rashçe, Saraj, së bashku me Venera Lumani dhe Fisnik Zeqiri

12 shkurt, 10:30

SHF "Mirçe Acev" - Shkup, së bashku me Kristina Arnaudova dhe Igor Angelov

12 shkurt, 12:30

SHF "Strasho Pinxhur" - Shkup, së bashku me Kristina Arnaudova dhe Igor Angelov

15 shkurt, 12:30

Klubi për fëmijë, Skopje City Mall (kati i dytë), së bashku me Gorast Cvetkovski

Nëse keni pyetje, sugjerime ose kërkesa në lidhje me Projektin e USAID-it "Leximi ju bën udhëheqës", kontaktoni me Ana Dimovska, me e-mail: ana@stepbystep.org.mk ose celular: 072/ 307-321.
Fondacioni për iniciativa arsimore dhe kulturore "Hap pas hapi" – Maqedoni
bul. Partizanski Odredi nr.72a, 1000 Shkup
tel: + 389 2 30 77 900